



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____/____/2018

V E N D I M

Nr. 235, Datë 22/11/2018

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 145, datë 13.09.2018, e Z. H.Ç., ku pretendohet diskriminim për shkak të “bindjeve politike”¹, nga ana e Degës Postare Gramsh, të Postës Shqiptare sh.a.,.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi²,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në ankesë, Z. H.Ç. ka filluar punë pranë Postës Shqiptare sh.a., Dega Gramsh, në vitin 2014, në pozicionin e postierit për Njësinë Administrative Kukur, të rrethit Gramsh. Ankuesi thekson faktin se ka filluar punë pranë kësaj shoqërie, në sajë të forcës politike Lëvizja Socialiste për Integrim, kur kjo e fundit ishte në koalicion me Partinë Socialiste. Ankuesi pretendon se në vijim të ndërprerjes së koalicionit ndërmjet dy forcave politike, ai është larguar nga puna nga forca politike në fuqi.

Për sa më sipër, Z. H.Ç. pretendon se në datën 05.04.2018 i është komunikuar verbalisht nga eprorët e tij, se është pushuar nga puna, por pa i dhënë paraprakisht asnjë motivacion, njoftim për zgjidhje të kontratës së punës e në vijim asnjë vendim për largim nga puna të titullarit të Postës Shqiptare sh.a., Filiali Gramsh. Ankuesi ka kërkuar të takojë drejtuesin e Filialit Elbasan, të Postës Shqiptare sh.a. dhe Drejtorin e Përgjithshëm të Postës Shqiptare sh.a., por nuk ka arritur të ketë takime me ta. Ankuesi pretendon gjithashtu se ka kërkuar librezën e punës, librezën e kontributeve, pranë Sektorit të Burimeve Njerëzore, por këto dokumente nuk i janë dhënë. Njëkohësisht, ai pretendon se në mungesë të aktit për largimin nga puna, nuk mund të aplikojë për të përfutuar përkrahje sociale.

Për sa më sipër, Z. H.Ç. pretendon se është larguar nga puna padrejtësisht, duke u diskriminuar për shkak të bindjeve të tij politike, të cilat i përkasin forcës politike Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI) dhe kërkon nga Komisioneri të konstatojë diskriminim për shkakun e sipërpërmendur.

¹ Referuar kartës së anëtarësisë nr. 2191, lëshuar në datën 23.03.2016, nga Lëvizja Socialiste për Integrim;

²Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

I. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Hapat proceduralë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

- A.** Pas analizimit paraprak të ankesës nr. 145, datë 13.09.2018, e Z. H.Ç., u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Në këto kushte, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.
- B.** Mbështetur në nenin 33, pika 7³, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua Postës Shqiptare sh.a., Filiali Gramsh dhe për dijeni ankuesit, me shkresën nr. 1253/1, datë 18.09.2018, ku kërkohej informacion, lidhur me çështjet e parashtruara nga ankuesi, si dhe iu kërkua të dërgoheshin aktet e poshtëcituarat:
- Kopje e kontratës së punës së ankuesit me Postën Shqiptare sh.a., Filiali Gramsh;
 - Kopje e librezës së punës së ankuesit;
 - Kopje e njoftimit për zgjidhje të kontratës së punës me ankuesin;
 - Kopje e aktit administrativ, të lëshuar nga titullari përkatës, për zgjidhjen e kontratës së punës me ankuesin;
 - Informacion, nëse ndaj Z. H. Ç. janë marrë masa disiplinore gjatë kohës që ka punuar pranë Postës Shqiptare sh.a., Filiali Gramsh.
 - Vlerësime për punën e kryer nga ankuesi ndër vite pranë Postës Shqiptare sh.a., Filiali Gramsh;
 - Informacion nëse gjatë së njëjtës periudhë kohore janë zgjidhur kontratat e punës me punonjës të tjerë të Postës Shqiptare sh.a., Filiali Gramsh. Nëse po, KMD kërkoi të dërgohej lista e punonjësve të larguar nga puna, pozicioni i punës, data e emërimit dhe e largimit nga puna.
 - Çdo informacion tjetër që ka lidhje me çështjen e parashtruar nga ankuesi.
- 1.** Në përgjigje të shkresës nr. 1253/1, datë 18.09.2018, së Komisionerit, Dega Postare Gramsh dërgoi shkresën nr. 322, datë 19.09.2018⁴, nëpërmjet së cilës e informon Komisionerin se Dega Gramsh e Postës Shqiptare sh.a., është degë e Postës Shqiptare, ndërkohë që Drejtoria e Filialit është në Elbasan. Njëkohësisht, Dega Gramsh, nëpërmjet shkresës së sipërpërmendur e ka përcjellë shkresën e KMD-së drejt Drejtorisë së Filialit Elbasan.

Në këto kushte, korrespondenca zyrtare e KMD-së është mbajtur me Filialin Elbasan të Postës Shqiptare sh.a. dhe Postën Shqiptare sh.a.

³ Neni 33, pika 7, i ligjit 10 221/2010, parashikon : “Me marrjen e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t’u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 30 ditëve nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacione dhe nga çdo person ose burim tjetër”.

⁴Shkresa i është dërguar për dijeni edhe ankuesit.

2. Filiali Elbasan, i Postës Shqiptare sh.a., dërgoi në adresë të Komisionerit shkresën nr. 1621, datë 24.09.2018, nëpërmjet së cilës informon se Z. H.Ç. ka filluar punë pranë Postës Shqiptare sh.a., Filiali Elbasan, në datën 03.05.2014, me detyrë punonjës me kohë të pjesëshme në Zyrën Postare Kukur/Dega e Postës Gramsh. Ankuesi ka patur detyrat funksionale si vijojnë: shpërndarjen e pensioneve në shtëpi dhe në portel, shpërndarjen e ndihmës ekonomike, kompensim të energjisë elektrike, shpërndarjen e objekteve postare për njësinë Administrative Kukur, si dhe arkëtim të faturave të OSHEE sh.a.

Nëpërmjet shkresës nr. 727, datë 21.02.2018, së Postës Shqiptare sh.a., drejtuar Filialit Elbasan, është përcjellë Programi i Zhvillimit Ekonomik për vitin 2018, si dhe struktura organizative e këtij filiali, ku është përcaktuar se nuk do të ketë punonjës me kohë të pjesëshme për këtë vit buxhetor. Në këtë mënyrë të gjithë punonjësve me kohë të pjesëshme u është suprimuar pozicioni i punës. Për nevoja të Degës së Postës Gramsh, shërbimet e ofruara në Zyrën Postare Kukur për muajt prill-qershor 2018, janë mbuluar nga punonjës të po kësaj dege, për të mos penguar vazhdimësinë e punës.

Me ndryshimin e programit ekonomiko-financiar për vitin 2018, në zbatim të vendimeve të Këshillit Mbikqyrës Nr. 8 dhe Nr. 9, datë 20.02.2018, si dhe shkresës nr.1291, datë 05.04.2018, të Postës Shqiptare sh.a. u miratua në parim numri i punonjësve me kohë të pjesëshme brenda fondit të pagave të programit ekonomik të vitit 2018. Me marrjen e këtij programi, Drejtorja e Filialit të Postës sh.a., Elbasan hartoi një program të veçantë të realizimit duke marrë masat për detajimin e të gjithë treguesve të programit, në bazë të funksionimit të zyrave postare me llogari më vete dhe të zberthyer për çdo vend pune sipas llojit të shërbimeve në copë dhe në vlerë. Me analizimin e treguesve financiarë për periudhën e punës së Z. H.Ç. është konstatuar mosrealizim i të ardhurave për shërbimeve të kryera dhe në këto kushte ka qenë e pamundur rikthimi i tij në punë.

Lidhur me pretendimet në ankesën e Z. H.Ç., në shkresën e Filialit Elbasan të Postës Shqiptare sh.a. sqarohet se Posta Shqiptare sh.a. është një shoqëri tregëtare dhe marrëdhëniet e punës në këtë shoqëri rregullohen nga dispozitat përkatëse të Kodit të Punës. Në asnjë lloj akti administrativ të nxjerrë nga kjo shoqëri nuk citohet apo përmendet togfjalëshi “bindje politike” dhe zgjidhja e marrëdhënies së punë është mbështetur në Kodin e Punës dhe në programin ekonomiko-financiar, ku suprimohen punonjësit me kohë të pjesëshme. Kontrata e punës së ankuesit është zgjidhur nga punëdhënësi, në zbatim të dispozitave të Kodit të Punës dhe parashikimeve të kësaj kontrate.

3. Në përgjigje të shkresës nr. 1253/1, datë 18.09.2018, të KMD-së, Posta Shqiptare sh.a dërgoi në adresë të tij, shkresën nr. 2756, datë 26.09.2018, ku jep pothuajse të njëjtin informacion, sikurse Filiali Elbasan. Ndër të tjera, në këtë shkresë theksohet fakti se referuar analizës së treguesve financiarë për periudhën e punës së Z. H.Ç. ka rezultuar se detyrat e tij kanë mosrealizim të të ardhurave dhe si rrjedhojë e këtij mosrealizimi ka qenë e pamundur rikthimi i tij sërish në punë.
4. Nëpërmjet shkresës nr. 1375, datë 08.10.2018, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtuar Administratorit të Postës Shqiptare sh.a, ku i kërkoi të

dispononte kopje të aktit administrativ, nëpërmjet së cilit është vendosur shkurtimi i punonjësve me kohë të pjesëshme pranë Filialit të Postës Elbasan, si dhe kopje e aktit administrativ, në të cilin reflektohet analiza e treguesve financiarë për periudhën e punës së Z. H.Ç., ku ka rezultuar se detyrat e tij kanë mosrealizim të të ardhurave në shërbimet e kryera.

5. Në përgjigje të shkresës nr. 1375, datë 08.10.2018, të KMD-së, Posta Shqiptare sh.a. dërgoi shkresën nr. 2923/1, datë 11.10.2018, nëpërmjet së cilës informon se Programi i Zhvillimit Ekonomik i Postës Shqiptare sh.a. është vendosur nga Këshilli Mbikqyrës i Shoqërisë dhe është miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Në lidhje me treguesit kryesorë teknikë të Zyrës Postare Kukur, të Degës Gramsh së Postës Shqiptare sh.a., Posta Shqiptare sh.a thekson faktin se konsiderohen të tillë: numri i klientëve që marrin pension në shtëpi apo numri i faturave të energjisë elektrike, të cilat nuk janë realizuar dhe kjo ka ndikuar edhe në mosrealizimin e treguesve të tjerë financiarë. Në këtë kontekst, Posta Shqiptare sh.a. sqaron se karakteristikë e Shërbimit Postar dhe Financiar është numri i klientëve që kryejnë shërbime në Zyrat Postare dhe jo volumi në lekë. Bashkëlidhur shkresës së mësipërme, Posta Shqiptare sh.a. ka dërguar dokumentacionin e kërkuar nga KMD.

II. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

Mbështetur në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri vlerëson se:

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë.

Në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit administrativ të ankesës nr. 145, datë 13.09.2018, së Z. H.Ç. rezulton se ankuesi është punësuar fillimisht pranë Postës Shqiptare sh.a., për një periudhë provizore 3-mujore, në detyrën agjent pranë Zyrës Postare Kukur, në Degën Postare Gramsh, nëpërmjet Urdhërit nr. 675/3, datë 30.04.2014, të Drejtorit të Filialit Elbasan, të Postës Shqiptare sh.a. Në vijim të Urdhërit të sipërpërmendur, në datën 03.05.2014, ndërmjet Z. H.Ç. dhe Postës Shqiptare sh.a., është lidhur një kontratë individuale pune me afat të caktuar. Në Seksionin “*Të përgjithshme*”, të kësaj kontrate përcaktohet se ajo është e vlefshme për 1 (një) vit dhe afati i vlefshmërisë së saj mund të zgjatet edhe për 1 (një) vit tjetër, me të drejtën e Postës Shqiptare sh.a.⁵. Në datën 16.03.2015, ndërmjet palëve të sipërpërmendura është lidhur një kontratë vijuese me afat të përcaktuar, në bazë të së cilës Z. H.Ç. do të ishte i punësuar pranë Postës Shqiptare, pranë Degës Postare Gramsh, në pozicionin e punës “agjent” edhe për një vit tjetër. Në përfundim të kësaj kontrate, në datën 16.03.2016, është lidhur një kontratë e tretë ndërmjet palëve, ku ankuesi do të mbante të njëjtin pozicion pune edhe për një periudhë tjetër 1 vjeçare. Në datën 16.03.2017, ndërmjet Filialit Elbasan të Postës Shqiptare sh.a dhe Z. H.Ç. është lidhur një kontratë punë me kohë të pjesëshme, sërish me afat të caktuar 1-vjeçar, ku tashmë ankuesi do të punësohej si punonjës me kohë të pjesëshme pranë Zyrës Postare Kukur/Dega Postare Gramsh.

⁵ Sikurse është cituar shprehimisht në kontratën individuale të punës

Me Vendimin nr. 38, datë 20.12.2017 të Këshillit Mbikqyrës së Postës Shqiptare sh.a. “*Mbi miratimin e Projekt-Programit të Zhvillimit Ekonomik të Shoqërisë Posta Shqiptare sh.a., për vitin 2018*” janë miratuar në parim treguesit e projektprogramit të zhvillimit ekonomik të vitit 2018. Me shkresën nr. 310, datë 24.01.2018, të Postës Shqiptare sh.a drejtuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, është dërguar për miratim Projekt-Programi i Zhvillimit Ekonomik të Shoqërisë. Ministria e Financës dhe Ekonomisë është aksioneri i vetëm, i cili zotëron 100% të aksioneve të Shoqërisë Posta Shqiptare sh.a. dhe nën këtë cilësi, si dhe mbështetur në mendimin e dërguar me shkresën nr. 1577/2, datë 07.02.2018, e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, ka miratuar programin ekonomik për vitin 2018 për Postën Shqiptare sh.a.⁶. Në referencë të strukturës organizative të Filialit Elbasan, të Postës Shqiptare sh.a., dërguar me anë të shkresës nr. 727, datë 21.02.2018, së Postës Shqiptare sh.a., rezulton se në strukturën e këtij filiali nuk ka punonjës me kohë të pjesëshme. Një gjë e tillë ka ardhur si rrjedhim i miratimit të Programit të Zhvillimit Ekonomik për vitin 2018, në bazë të së cilit për këtë vit buxhetor është vendosur të mos ketë punonjës me kohë të pjesëshme. Mbështetur në informacionin e dërguar me e-mail nga Drejtori i Filialit Elbasan të Postës Shqiptare sh.a. në adresë të Komisionerit, rezulton se pas miratimit të strukturës së re organizative të këtij filiali nga Këshilli Mbikqyrës i Postës Shqiptare sh.a., janë suprimuar pozicionet e punës për 34 punonjës me kohë të pjesëshme pranë Filialit Elbasan, të Postës Shqiptare dhe për Degën Postare Gramsh janë suprimuar përkatësisht pozicionet e punës së 9 punonjësve me kohë të pjesëshme. Në këtë kontekst, rezulton se ankuesi nuk i është nënshtruar një trajtimi të pabarabartë, pasi marrëdhëniet e punës janë ndërprerë për të gjithë punonjësit me kohë të pjesëshme pranë Filialit Elbasan, të Postës Shqiptare sh.a.

Në ankesën e tij, Z. H.Ç. pretendon se i është komunikuar verbalisht se është pushuar nga puna, por pa i dhënë paraprakisht asnjë motivacion, njoftim për zgjidhje të kontratës së punës e në vijim asnjë vendim për largim nga puna të titullarit të Degës Postare Gramsh. Në këtë kontekst Komisioneri thekson faktin se punëdhënësi i ankuesit është Filiali Elbasan, i Postës Shqiptare Gramsh dhe jo Dega Postare Gramsh. Përsa më sipër, nga aktet e depozituara në cilësinë e provës nga ana e Filialit Elbasan, të Postës Shqiptare sh.a. rezulton se nëpërmjet shkresës nr. 611, datë 21.03.2018, të Filialit Elbasan, të Postës Shqiptare sh.a., ankuesi është njoftuar mbi suprimimin e pozicionit të tij të punës. Në këtë shkresë theksohet fakti se në pamundësi për ta akomoduar në një vend tjetër, pune, për shkaqe të justifikuara dhe të arsyeshme ligjore, do të përfundohet marrëdhënia e tij e punësimit në datën 31.03.2018. Për këtë arsye, ankuesit i është kërkuar të marrë pjesë në një takim me punëdhënësin, që do të zhvillohej në datën 26.03.2018, ora 10:00, në ambientet e Postës Shqiptare sh.a. Në referencë të procesverbalit të takimit nr. 639, datë 26.03.2018, rezulton se ankuesi është paraqitur në takimin e datës 26.03.2018 dhe ka marrë dijeni zyrtarisht mbi suprimimin e pozicionit të tij të punës dhe zgjidhjes së marrëdhënieve të tij të punës me Postën Shqiptare sh.a., pasi e ka nënshkruar procesverbalin e takimit të sipërpërmendur. Në vijim, është miratuar Vendimi nr. 688, datë 29.03.2018, nëpërmjet së cilit ankuesi lirohet nga detyra me motivacionin e zgjidhjes së menjëherëshme të marrëdhënieve të punës, për shkaqe të justifikuara, pasi për vitin buxhetor 2018 nuk do të ketë punonjës me kohë

⁶ Referuar shkresës nr. 1942, date 09.02.2018, të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

të pjesëshme, pranë Filialit Elbasan të Postës Shqiptare sh.a. Gjithashtu, vlen të theksohet fakti se mbështetur në shënimin e vënë në Regjistrin Themeltar të punonjësve të Filialit Elbasan të Postës Shqiptare sh.a. rezulton se ankuesi ka nënshkruar se ka tërhequr librezën e tij të punës, në datën 12.09.2018, që përkon me një ditë para se të depozitonte ankesën e tij pranë KMD-së. Në këtë kontekst, Komisioneri gjykon se ankuesi ka marrë dijeni mbi ndërprerjen e marrëdhënieve të tij të punës me Filialin Elbasan, të Postës Shqiptare sh.a., duke rrëzuar pretendimin e tij për mosnjohim dhe mosmarrje dijeni, lidhur me aktet, nëpërmjet së cilave i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës.

Për sa më sipër, në referencë të nenit 7, pika 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri gjykon se Filiali Elbasan, i Postës Shqiptare sh.a. dhe Dega Postare Gramsh nuk kanë ndërmarrë veprime që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj ankuesit, ose që e kanë ekspozuar atë, ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, në krahasim me persona të tjerë, që ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme me të.

Në mungesë të trajtimit të padrejtë, disfavorizues e të pabarabartë, Komisioneri gjykon se nuk kemi të bëjmë me diskriminim për shkakun e pretenduar nga ankuesi.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 18 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, , nenin 17, të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenin 9, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), nenin 1, nenin 7, pika 1, nenet 11-13, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a) e nenin 33, pikat 10-11, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit, për shkak të “bindjes politike”, të Z. H.Ç., nga ana e Filialit Elbasan, të Postës Shqiptare sh.a. dhe Degës Postare Gramsh, pranë këtij filiali.
2. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim, brenda afateve ligjore, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Robert GAJDA

KOMISIONERI

(Shkak – bindja politike
Fusha – punësim)